



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 12. 07. 2010, në orën 12:10
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Nexhat Daci, Enis Kervan, Ismet Beqiri, Ibrahim Gashi dhe Sllobodan Petroviq.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 8 qershor 2010;**
- 3. Programi i Komisionit;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 8 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 8 qershor 2010, u miratua njëzëri.

3. Programi i Komisionit

Sabri Hamiti – Tha se në kuadër të programit të Komisionit është edhe projekti për organizimin e Konferencës rajonale lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe integrimet evropiane. Në këtë drejtim, janë njoftuar të gjithë kryetarët e komisioneve të vendeve të rajonit dhe nga katër prej tyre e kemi marrë përgjigjen. Planifikohet që ky takim me komisionet homologe të parlamenteve të rajonit të mbahet në javën e tretë të muajit shtator në Prishtinë. Pas marrjes së konfirmimit nga vendet e interesuara për pjesëmarrje në konferencë mbetet që të përgatitet agjenda e këtij takimi. Për këtë projekt propozoi që Komisioni t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit për lejimin e mbajtjes së këtij takimi.

Ibrahim Gashi - Propozoi, duke pasur parasysh se shtatori është afër, që kërkesa për kryesi të përcillet shpejt. Pritet punë për të gjithë dhe nga një shtatori duhet të jemi aktivë.

Nexhat Daci - Mendon se puna gjatë këtij takimi duhet të organizohet në takime plenare, e jo në grupe punuese. Komisioni do të jetë i suksesshëm në këtë takim, ndërsa protokoli duhet të jetë në funksion dhe në nivelin e duhur.

Komisioni pas diskutimit lidhur me organizimin e Konferencës rajonale nxori këtë

P e r f u n d i m

Të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që të lejojë organizimin e Konferencës Rajonale të komisioneve për punë të jashtme, nga Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme.

Sabri Hamiti – I njoftoi se gjatë vizitës në Bruksel kanë pasur rastin të takohen me zonj. Lunacek, e cila në fakt ka qenë sponsoruese e Rezolutës, e cila është miratuar në Parlamentin Evropian dhe ka punuar shumë për të, siç kanë punuar edhe disa deputetë që merren me çështjen e Ballkanit Perëndimor, z. Kacin etj. Kjo Rezolutë është me rëndësi të jashtëzakonshme për Kosovën, sepse është edhe thirrje për njohje nga 5 vendet e BE- së që nuk e kanë njohur ende Kosovën, njëkohësisht është një nisje drejt procesit për liberalizim të vizave dhe një analizë reale e gjendjes në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit